



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 486 / Prot

Tiranë më datë 23 / 04 / 2018

UDHËZIM

Nr. 393, datë 23 . 04 . 2018

Për

Zbatimin e VKB Nr.40, dt.29.03.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.59, dt.30.12.2015, “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, i ndyshuar.

Mbështetur në Vendimin e Bashkisë Tiranë me Nr.17381, datë 06.06.2016 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të QEZHEF-ve” Njësi në varësi të Bashkisë së Tiranës, Urdhërit Nr.7244, datë 04.03.2016 të Kryetarit të Bashkisë “Për riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë

U D H Ë Z O J:

1. Të përfitojnë reduktim të plotë pagese, fëmijët e familjeve si më poshtë :
 - 1.1 Fëmijë me statusin e jetimit.
 - 1.2 Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.
 - 1.3 Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
 - 1.4 Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
 - 1.5 Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
 - 1.6 Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - 1.7 Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës.
2. Dokumentacioni i duhur për secilën nga kategoria të mësipërme.

➤ **Fëmijë me statusin e jetimit:**

- Librezja e statusit të jetimit të fëmijës.
- Çertifikata personale e fëmijës dhe familjare.
- Vërtetimi për frekuentimin e çerdhës ose kopshtit

- **Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit:**
 - Libreza e statusit të kujdestarit ligjor të fëmijës.
 - Çertifikata personale e fëmijës dhe familjare.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit.

 - **Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor;**
 - Raporti mjeko-ligjor i fëmijës.
 - Çertifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit.

 - **Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor;**
 - Raporti mjeko-ligjor i kujdestarit ligjor të fëmijës.
 - Çertifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit.

 - **Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike**
 - Çertifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit.
 - Vërtetim nga njësia bashkiake që konfirmon trajtimin me ndihmë ekonomike.

 - **Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës:**
 - Çertifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit
 - Vërtetim pagese i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë. (24 000 lek).
 - Kartela personale e punëkërkuessit (nga zyra rajonale e punësimit).
 - Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave që s'ka aktivitet privat.

 - **Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës:**
 - Çertifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit
 - Vërtetim pagese i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë. (24 000 lek).
 - Kartela personale e punëkërkuessit (nga zyra rajonale e punësimit).
 - Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave që s'ka aktivitet privat.
3. Zbatimin e VKB-së Nr.40, datë 29.03.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.59, dt.30.12.2015, “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, i ndyshuar, nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe Hartimit të listave për fëmijët që përfitojnë reduktimit të plotë të pagesave të ditëgrënieve në çerdhe dhe kopshte.

4. Njoftimin e përgjegjëseve të çerdheve dhe drejtorive të kopshteve publike të Bashkisë së Tiranës dhe marrjen e masave nga ana e tyre për informimin e prindërve për ndryshimet e kategorive dhe dokumentacionin përkatës të tyre, si dhe dërgimin e dokumentacionit plotësues sipas ndryshimeve deri në datën 25.05.2018.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

